**AKT THEMELIMI**
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**"Cappuccino 1" Shpk**

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshur:
Sot, më datë 06.01.2025 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "Cappuccino 1" Shpk, me Ortak të vetëm shtetasin, Z. Eduard Ferhat Çullhaj i datëlindjes 31.01.1989, lindur në Durrës dhe banues në Lagjien Nr.9, Shoqeria Vllaznia, Nd.15, H.3, Durrës 2003, shtetas shqiptar i identifikuar me ID, I90131059G e cila do të funksionojë në bazë të këtij, ***AKT-THEMELIMI***.

## LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

**NENI 1**

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është "Cappuccino 1" Shpk.

## SELIA E SHOQËRISË

**NENI 2**

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare "Cappuccino 1" Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Lagjia Nr. 5, Rruga Adria, Rruga drejt Muzeumit, Durrës.

## REGJIMI JURIDIK

**NENI 3**

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.
Shoqëria fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË

**NENI 4**

*Objekt i Shoqërisë Tregtare "Cappuccino 1" Shpk është:*

Bar-kafe-restorant-pastiçeri. Dhënie me qira të apartamenteve e ambjenteve të shërbimit, dhënie me qira të mjeteve të transportit dhe transport për të tretë. Shërbime hotelerie. Veprimtari në fushën e investimit, investitor, ndërtues. Tregeti te mallrave Ushqimore dhe Industrial. Veprimtari ne zenien dhe tregtimin e peshkut.

Eduard Çullhaj

## KOHËZGJATJA

**NENI 5**

Shoqëria Tregtare "Cappuccino 1" Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.
Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për cfarëdo lloj shkaku.

## KAPITALI I SHOQËRISË

**NENI 6**

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "Cappuccino 1" Shpk, përbëhet prej 100,000.00 (njëqindë mijë) lekë.
Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e vetëm të:

1. Otaku i Vetëm Themelues Z. Eduard Ferhat Çullhaj: Zotëruese 1 ( një ) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 100,000.00 (njëqindë mijë) lekë.

## ADMINISTRIMI

**NENI 7**

Administrator i Shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Ortakëve është Z. Eduard Ferhat Çullhaj me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

## TË DREJTAT E SHOQËRISË

**NENI 8**

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe te nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit.
Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.
Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri ne kufirin e vlerës se kontributit te Kapitalit Themeltar.

## VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

**NENI 9**

Viti financiar i shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

## SHPËRNDARJA E FITIMIT

Eduard Çullhaj

**NENI 10**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.
Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

**LIKUJDIMI**

**NENI 11**

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër".
Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

***ORTAKËT***
***E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***
**"Cappuccino 1" Shpk**

Eduard Ferhat Çullhaj

/______________________/

Eduard Çullhaj